



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. 1048 prot.

Gjirokastrë, më 02.07. 2024

APROVOI

REKTOR

Prof. dr. Bektash MEMA



Lënda: Hapet thirrja për shkëmbim studentësh në kuadër të Programit Erasmus+ në Universitetin Mesdhetar të Kretës

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Kretës hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë.

Sipas Marrëveshjes Ndërinstitucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me **1 pozicion** për studentët e Departamentit të Infermierisë, cikli i parë i studimit (Bachelor), viti i dytë dhe i tretë, i/e cili/a do të angazhohet në praktikë mësimore në Universitetin e Kretës. Praktika do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2024-2025**, semestri i parë ose i dytë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht ose greqisht.

Të interesuarit duhet të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **19.07.2024**:

- vërtetim studenti;
- listë notash;
- letër interesi, në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në anglisht;
- provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze ose greke në nivelin B1;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ-së, dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet Universitetit të Kretës, për përzgjedhjen përfundimtare të aplikantit/aplikantes.

Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor

Irma Gjollëshi